



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22 Shkurt 2021

Nr: 94

VENDIM

PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË CENTRISTE MIRËQENIES POPULLORE
SHQIPTARE PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR
KUVENDIN TË DATËS
25 PRILL 2021

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 64 dhe 92/2 pika 2 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

V Ë R E J

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare, me shkronja nistore “PCMPSH”, nëpërmjet Kryetarit të saj, z. Vladimir Lulaj, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen më datë 25 Prill 2021, administruar me nr. 1184 prot., datë 15.02.2021 dhe nr. 1290 prot., datë 18.02.2021.

Kërkesa e paraqitur nga Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare, respekton afatin kohor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.



Data: 22 Shkurt 2021

Nr. 94

Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021

Dokumentacioni i paraqitur nga Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare, për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, përbëhet si më poshtë:

- a) Vërtetimi lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 19.01.2021, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare, me initiale “PCMPSH”, me Kryetar z. Vladimir Lulaj, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë;
- c) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresa e partisë;
- d) specimeni i vulës së partisë;
- dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë (z. Ali Hyka);
- e) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në (z. Vladimir Lulaj);

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia e Punës e Shqipërisë, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 92/2 pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon hapjen e llogarisë së posaçme në banka nga subjekti zgjedhor si dhe duhet të deklarohet në momentin e regjistrimit të partive politike sipas nenit 64 të Kodit Zgjedhor.

Referuar dispozitave të sipërcituara, Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare nuk ka depozituar deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn sipas Modelit 01 si dhe hapjen e numrit të llogarisë së posaçme sipas deklaratës Model 01/1 të miratuar me udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1279 prot., 17.02.2021, i ka kërkuar kryetarit të partisë z. Vladimir Lulaj, plotësimin e dokumentacionit për depozitimin e deklaratës të nënshkruar nga kryetari i partisë Model 01 si dhe hapjen e numrit të llogarisë së posaçme sipas Modelit 1/1 të miratuar me udhëzimin nr.01, datë 23.12.2020, brenda 2 ditëve nga marrja e njoftimit. Rezulton se z. Lulaj, ka marrë dijeni në datën 17.02.2021.



Me shkresën nr.1290 prot., datë 18.02.2021, z. Lulaj ka depozituar vetëm deklaratën e nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn, sipas Modelit 01, të miratuar me Udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n” e 2, 64 dhe 92/2 pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Të mos regjistroj si subjekt zgjedhor, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare, me Kryetar z. Vladimir Lulaj, me shkronjat nistore “PCMP SH”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

